



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 299/3 Prot.

Tiranë, më 27-01 2023

VENDIM

Nr. 7 dt. 27-01 2023

“PËR  
PËRCAKTIMIN RAST PAS RASTI TË SEZONIT TË POSAÇËM TË PROVIMIT TË  
DIPLOMITIT”

Në zbatim të nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në nenin 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 107 të Rregullores së UST-së, si dhe mbështetur në shkresën e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit nr.60 prot., datë 09.01.2023 me objekt “Për një ndryshim në rregulloren për provimin e diplomimit në sezonin e dimrit”, Senati Akademik i Universitetit të Sporteve të Tiranës, i udhëhequr nga nevojat praktike të studentëve si dhe faktit që Rregulloret e Fakulteteve të UST-së parashikojnë mundësinë e diplomimit në sezonet e rregullta (sezoni i dimrit dhe sezoni i verës) dhe sezonin e vjeshtës në mbledhjen e datës 27.01.2023,

V E N D O S I :

1. Të ndiqet praktika e shtimit rast pas rasti me vendime të Njësive Kryesore, të sezonit të dimrit, për kryerjen e provimit të diplomimit të studentëve.
2. Ky vendim t’i përcillet për njohje dhe zbatim Njësive Kryesore dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

